



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1135/2 Prot.

Tiranë, më 03 / 08 / 2021

V E N D I M

Nr. 141, Datë 03 / 08 / 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 143 Regj, datë 30.07.2021, të paraqitur nga subjekti ankues, F. B, kundër Kryetares së Bashkisë Delvinë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, F. B, në parashtrimet e paraqituara në ankesën e sjellë pranë KMD-së, informon se, prej më shumë se 5 vitesh është punonjës i administratës së Bashkisë Delvinë. Ankuesi shprehet se:

“Në vitin 2016 kam qenë anëtar i Partisë Socialiste për Integrim (LSI), por asnjëherë nuk kam qenë pjesë e fushatave elektorale dhe as aktiv në politikë, dhe as jam aktualisht. Gjatë gjithë kohës kam punuar me ndershmëri, kam qenë korrekt si me orarin, ashtu dhe me detyrat e punës, gjë e cila vërtetohet me performancën time në punë. Nuk kam marrë asnjë vërejtje, paralajmërim apo masë tjetër disiplinore”.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Në vijim, ankuesi shprehet se, ndaj tij është ushtruar presion verbal dhe shkresor, i vazhdueshëm nga ana e Kryetares së Bashkisë Delvinë, që pas emërimit të saj në krye të këtij institucioni, dhe se në këto kushte nuk mund të ushtrojë i qetë detyrën e tij. Në këtë kontekst, ankuesi ka cituar se, atij i është mohuar leja e zakonshme vjetore 2021, si dhe është ndërmarrë masë disiplinore ndaj tij.

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, rezulton se, ndaj ankuesit i kishte filluar ecuria disiplinore, në muajin qershor 2021, lidhur me moszbatimin e detyrës funksionale, dhe se për këtë fakt ishin realizuar disa takime dhe bisedime pranë Komisionit Disiplinor të Bashkisë. Subjekti ankues ka paraqitur mosdakordësinë dhe kundërshtitë e veta lidhur me sa ka konstatuar Komisioni Disiplinor.

Ankuesi shpreh shqetësimin e tij, lidhur me vijimin e marrëdhënieve të punës me Bashkinë, duke cituar se: *“Kryetarja e Bashkisë më vështirëson punën duke më urdhëruar të dal në terren, jashtë territorit të Bashkisë Delvinë për arsye pune, duke mos më vënë në dispozicion mjet transporti por më detyron të lëviz në këmbë, duke më thënë: “Nëse e bën mirë, nëse nuk mundesh lëri vendin një tjetri”, duke më hequr ditën e punës me arsyetimin se kur jam në terren, nuk jam kthyer në orar në institucion. Kryetarja nuk i është përgjigjur asnjë kërkesë që kam paraqitur, por sërish më bën presion dhe diskriminon duke më akuzuar se nuk bëj detyrën, presion ky për të dhënë dorëheqjen nga puna.*

Të gjitha këto presione dhe diskriminime ndaj meje janë për shkaqe dhe bindje politike, pasi M. Q. ma ka shprehur vetë se nuk e kam votuar në zgjedhjet e 30 qershorit të vitit 2019, periudhë kur u zgjodh Kryetare e Bashkisë Delvinë, si dhe më ka kërkuar të anëtarësohem në Partinë Socialiste dhe të jem aktivist i saj, formë presioni kjo gjë për të cilën nuk e kam pranuar pasi nuk jam marrë dhe as merrem me fushatat apo aktivitetet politike”.

Në përfundim të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri: *“Ndalimin e formave të presionit dhe të diskriminimit nga ana e Kryetares së Bashkisë”.*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues.

- Për këtë arsye, nëpërmjet e-mail-it të datës 28.07.2021, KMD, i ka kërkuar ankuesit të provojë dhe dokumentojë shkakun e pretenduar dhe të argumetojë lidhjen e tij me trajtimin e pafavorshëm.
- Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, nëpërmjet postës elektronike të datës 29.07.2021, subjekti ankues ka dërguar parashtrime, por sërish nuk ka dokumentuar shkakun për të cilin ka pretenduar diskriminimin.

Në parashtrimet e sjella nëpërmjet e-mailit, lidhur me sqarimin dhe dokumentimin e shkakut për të cilin ka pretenduar diskriminimin, ankuesi, ndër të tjera citon se: *“Në lidhje me ankesën që ju kam dërguar, po ju sqaroj se nuk disponoj asnjë dokument apo kartë anëtarësie”.*

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në informacionin dhe dokumentacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “bindja politike”. Subjekti ankues në rastin në fjalë, nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e kësaj karakteristike individuale specifike (siç është bindja politike në këtë rast).

Përkundrazi, ankuesi ka deklaruar se nuk disponon asnjë dokument apo kartë anëtarësie të asnjë partie politike dhe se, i është kërkuar verbalisht nga Kryetarja e Bashkisë të aktivizohet dhe anëtarësohet në Partinë Socialiste të Shqipërisë (PS).

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se thëniet e ankuesit lidhur me kërkesën e M. Q. për aktivizimin e tij politik në PS, mbeten të karakterit deklarativ dhe të padokumentuara në ndonjë formë nga subjekti ankues.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin ankuesi pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat, si, mos miratimi i lejes vjetor, ecuria disiplinore e iniciuar ndaj tij, etj. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga ankuesi lidhen pikërisht me këtë “shkak”.

² Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

Komisioneri në punën e tij i referohet gjithashtu praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.*

- Referuar citimit sa më lart, ankuesi nuk solli asnjë provë që të dokumentonte “shkakun” e pretenduar prej tij.
- Përkundrazi, ankuesi ka pohuar se nuk është pjesë aktive e asnjë force politike në vend, dhe se nuk është i angazhuar në asnjë fushatë apo aktivitet politik të tyre. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se ai nuk i ka të shprehura dhe të njohura publikisht bindjet e tij politike.
- Referuar deklaratimeve të ankuesit, ai ka pohuar se kërkesa nga ana e Kryetares për aktivizmin e anëtarësimin e tij në PS, i është bërë *verbalisht*.
- Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, ky pretendim mbetet i karakterit deklarativ, i paprovuar apo mbështetur në prova të tjera, të drejtëpërdrejta apo të tërthorta.

Diskriminimi³ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, lidhur me pretendimin e tij për diskriminim.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa

³ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Lidhur me paligjshmëritë e pretenduara nga ankuesi përse i takon mosmiratimit të lejes vjetore apo ecurisë disiplinore të iniciuar ndaj tij, nga ana e Bashkisë, Komisioneri i sugjeron ankuesit që këto kërtime t'ia drejtojë gjykatës kompetente, si organ i caktuar me ligj për zgjidhjen e konflikteve e mosmarrëveshjeve gjatë marrëdhënieve të punës.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, F. B, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim
Shkaku: Bindjet politike
Lloji i vendimit: Mospranim